

VENDIM
Nr. 34, datë 17.11.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 3.11.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 2 (R) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: ROLAND KARAXHA

SUBJEKT I INTERESUAR:

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-129 (16), datë 21.1.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe lënia në fuqi e vendimit nr. 54, datë 15.3.2017 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkesit Roland Karaxha, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Roland Karaxha është proceduar penalisht për veprën penale “Plagosja e rëndë me dashje në bashkëpunim”, të parashikuar nga nenet 88, paragrafi 1, dhe 25 të Kodit Penal (KP). Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1396, datë 3.6.2014, e ka deklaruar fajtor sipas akuzës dhe e ka dënuar me 3 vjet e 6 muaj burgim. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1037, datë 27.5.2015.

2. Në datën 22.12.2015 Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 154/2015 “Për dhënie amnistie” (*ligji nr. 154/2015*), i cili ka hyrë në fuqi në datën 21.1.2016. Qëllimi i tij është dhënia e amnistisë tërësore ose të pjesshme për dënimet penale të formës së prerë, sipas disa kriterëve të përcaktuara. Neni 2 i ligjit parashikon se i dënuar, në kuptim të tij, konsiderohet personi i dënuar nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë, deri në datën 30 nëntor 2015. Ndërsa neni 4 parashikon shprehimisht se “*të gjithë personave të dënuar, të cilët nuk përfitojnë nga parashikimi i nenit 3 dhe*

përfshihen nga kriteret ndaluese, të parashikuara në nenin 5 të këtij ligji u amnistohet: a) 1,5 vjet të mbetura për personat e dënuar gra dhe personat që në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë të mitur. b) 1 vit të mbetur për personat e dënuar burra”.

3. Kërkuesi, bazuar në nenin 4, shkronja “b”, të ligjit nr. 154/2015, ka kërkuar në gjykatë uljen e dënimit me 1 vit për shkak të amnistisë me pretendimin se nuk përfitonte nga neni 3, por njëherazi nuk ishte as në kushtet ndaluese të nenit 5 të ligjit, duke parashtruar se i kishin mbetur për të vuajtur 2 vjet e 10 ditë burgim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 1106 (62-2016-3136), datë 30.6.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se i dënuari nuk i plotësonte kriteret për të përfituar nga ligji për amnistinë, pasi në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 154/2015, atij i kishte mbetur për të vuajtur më shumë se 1 vit dënim me burgim.

4. Mbi bazën e ankimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit Vlorë, në prani të prokurorit, kërkuesit dhe avokatit të zgjedhur, e ka ndryshuar vendimin e shkallës së parë dhe, duke e gjykuar çështjen në fakt, me vendimin nr. 54, datë 15.3.2017, ka vendosur pranimin e kërkesës. Ajo gjykatë ka arsyetuar se neni 4 i ligjit nr. 154/2015 nuk ka të bëjë me të dënuarit burra, të cilëve u ka mbetur pa vuajtur vetëm 1 vit burgim, pasi kjo situatë rregullohej nga neni 3 i këtij ligji. Neni 4 i tij parashikonte amnisti në formën e uljes së dënimit për të dënuarit që nuk përfitojnë nga neni 3, si dhe që nuk janë në kushtet ndaluese të nenit 5 të ligjit.

5. Kundër këtij vendimi, në datën 10.4.2017, ka ushtruar rekurs prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, të cilin e ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Kjo e fundit, me komunikimet e datës 23.5.2017, i ka dërguar kërkuesit në adresën e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, Fier kopje të rekursit të prokurorisë. Në dëftesën e komunikimit të kërkuesit është vendosur shënimi “liruar”.

6. Arsyeja e lirit lidhet me faktin se në kohën që zhvilloheshin procedurat gjyqësore të kërkesës, bazuar në ligjin nr. 154/2015, Kuvendi kishte miratuar një ligj tjetër amnistie, konkretisht ligjin nr. 141/2016, datë 22.12.2016 “Për dhënie amnistie”. Në bazë të këtij ligji, kërkuesi ka paraqitur kërkesë tjetër në gjykatë për shuarjen e dënimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 635 (62-2017-1774), datë 19.4.2017, e ka pranuar kërkesën, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të tij. Në mënyrë të përmbledhur, gjykata ka arsyetuar se në kushtet kur kërkuesi me vendimin nr. 54, datë 15.3.2017 të Gjykatës së Apelit Vlorë kishte përfituar 1 vit ulje dënimi nga amnistia e dhënë me ligjin nr. 154/2015, për rrjedhojë i mbeteshin për të vuajtur 6 muaj e 25 ditë burgim, pra më pak se 1 vit burgim. Në tekstin e vendimit kryesekretarja e gjykatës ka shënuar se vendimi ka marrë formë të prerë në datën 3.5.2017, pra pa u ankimuar nga prokuroria.

7. Me marrjen e njoftimit për lirimin e kërkuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier në datën 6.6.2017 ka dërguar kopje të rekursit të prokurorisë ndaj vendimit nr. 54, datë 15.3.2017 të Gjykatës së Apelit Vlorë në vendbanimin e kërkuesit në Farkë e Vogël, Tiranë. Dëftesa e komunikimit është kthyer me shënimin e shërbimit postar “i panjohur”.

8. Më tej, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, për t’i komunikuar kërkuesit rekursin e prokurorisë, i është drejtuar Bashkisë Tiranë me kërkesën nr. 1106, datë 15.6.2017, për të realizuar njoftimin me shpallje. Me shkresën nr. 24320/1 prot., datë 22.6.2017, kjo e fundit i ka drejtuar administratorit të njësisë administrative Farkë dhe për dijeni gjykatës kërkesën për afishimin e shpalljes pranë asaj njësie. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, duke e konsideruar të kryer njoftimin e kërkuesit për rekursin e prokurorisë, ka përcjellë dosjen gjyqësore në Gjykatën e Lartë, e cila ka regjistruar çështjen penale në datën 7.7.2017.

9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se rekursi i prokurorit përmbante shkaqe të parashikuara nga ligji dhe ka vendosur shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me pjesëmarrjen e palëve. Seanca e parë është caktuar në datën 14.1.2022, por kërkuesi dhe mbrojtësi i zgjedhur nuk janë paraqitur. Seanca e dytë është zhvilluar në datën 21.1.2022, në të cilën ka marrë pjesë mbrojtësi i

caktuar kryesisht dhe, në përfundim të saj, Kolegji Penal ka dhënë vendimin nr. 00-2022-129 (16), datë 21.1.2022, me të cilin ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me arsyetimin se vendimi i gjykatës së apelit binte në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal në të tilla raste. Ky kolegji ka interpretuar togfjalëshin “*një vit i mbetur*”, që është pjesë e përmbajtjes së nenit 4, shkronja “b”, të ligjit nr. 154/2015, duke konkluduar se përfitues të amnistisë janë personat të cilëve u ka mbetur një vit pa vuajtur nga dënimi i dhënë dhe “jo një vit nga dënimi i mbetur pa vuajtur kur i dënuari ka për të vuajtur një masë më të madhe dënimi se një vit”.

10. Në datën 20.5.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-129 (16), datë 21.1.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 54, datë 15.3.2017 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

11. Kolegji i Gjykatës, në datën 19.7.2022, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

12.1 *E drejta e mbrojtjes*, e garantuar nga neni 31 i Kushtetutës, pasi ai nuk ka marrë njoftim për t’u përfaqësuar në gjykim nga një avokat mbrojtës.

12.2 *Interpretimi i gabuar i ligjit*, pasi Gjykata e Lartë ka interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 4 të ligjit nr. 154/2015, duke qenë se për shkak të rrethanave dhe kushteve të përcaktuara në këtë ligj ai e përfitonte uljen me një vit të dënimit me burgim.

13. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

13.1 Pretendimi për cenimin e *së drejtës së mbrojtjes* nuk qëndron, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka respektuar kërkesat procedurale të njoftimit. Në kushtet kur kërkuesi nuk kishte zgjedhur mbrojtës, në zbatim të neneve 49 dhe 437, pika 3, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), Gjykata e Lartë i ka caktuar një mbrojtës kryesisht, i cili ka paraqitur prapësimet në lidhje me rekursin objekt shqyrtimi.

13.2 Pretendimi për interpretim të gabuar të ligjit penal nga ana e Gjykatës së Lartë nuk përfshihet në *juridiksionin kushtetues* dhe si i tillë është i pabazuar. Interpretimi i ligjit penal është prerogativë ekskluzive e Gjykatës së Lartë, funksion të cilin ajo e ushtron bazuar në nenin 141 të Kushtetutës dhe nenet 432 e vijues të KPP-së.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

14. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

15. Gjykata çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, pasi është palë në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar. Ai ka shteruar *mjetet juridike efektive në dispozicion*, pasi kundërshton vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 21.1.2022 që ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të inicuar prej tij për të përfituar nga amnistia. Kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, pasi ankimi është paraqitur në datën 20.5.2022, pra brenda afatit 4-mujor nga dhënia e vendimit të Gjykatës së Lartë, sipas përcaktimit të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 8577/2000.

16. Lidhur me kriterin e legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000, ka theksuar se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur.

17. Në këtë pikëpamje, ashtu siç ka prapësuar me të drejtë edhe Prokuroria e Përgjithshme, pretendimi i kërkuesit për mënyrën se si Gjykata e Lartë ka interpretuar nenin 4 të ligjit nr. 154/2015 nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës, ndaj si i tillë nuk mund të merret në shqyrtim. Interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimet nr. 5, datë 1.3.2018; nr. 23, datë 20.4.2016; nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ndërhyr vetëm kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Në këto raste, ajo nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Për sa i takon pretendimit tjetër të kërkuesit, që ka të bëjë me cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në aspektin e së drejtës së mbrojtjes, të garantuar nga nenet 31 dhe 42 të Kushtetutës, ai bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj Gjykata në vijim do të analizojë bazueshmërinë e tij në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së mbrojtjes

19. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për të zgjedhur një avokat për ta përfaqësuar në gjykim dhe se ai ka marrë dijeni pas dhënies së vendimit, në momentin e arrestimit në datën 12.4.2022. Prokuroria ka ushtruar rekurs vetëm kundër vendimit të tij, ndërkohë që nuk ka bërë të njëjtën gjë ndaj vendimit gjyqësor për babain e tij, i cili kishte përfituar në të njëjtën mënyrë nga amnistia.

20. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se pretendimi i kërkuesit nuk qëndron. Sipas saj, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka konstatuar se nga kërkuesi nuk është autorizuar një mbrojtës dhe në zbatim të nenit 437, pika 3, të KPP-së i lidhur me nenin 49 të tij, i ka caktuar kryesisht një të tillë. Mbrojtësi i caktuar, në ushtrim të të drejtave të kërkuesit, ka paraqitur prapësimet në lidhje me rekursin objekt shqyrtimi.

21. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se kushdo, në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Në veçanti për procesin penal, shkronja “ç” e nenit 31 të Kushtetutës parashikon se kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t’i sigurohet mbrojtje falas kur nuk ka mjete të mjaftueshme.

22. Gjykata ka pranuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal ka përmbajtje substanciale, ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike, dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimin nr. 35, datë 1.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht në procesin penal, mbrojtja e të pandehurit lidhet ngushtë me barazinë e armëve dhe kontradiktoritetin, të cilat së bashku përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e tyre, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij (*shih vendimin nr. 71, datë 30.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka pohuar se në kuptim të nenit 6 § 3 (c) të Konventës, që parashikon të drejtën për ndihmë ligjore “praktike dhe efektive”, thjesht “caktimi” i një avokati nuk siguron ndihmë efektive dhe se autoritetet kanë detyrimin të sigurohen që ai të përmbushë detyrat e tij (*shih Falcao dos Santos kundër Portugalisë, viti 2012*). Për shkak të pavarësisë së profesionit të avokatit, sjellja e mbrojtësit është në thelb një çështje midis të pandehurit dhe përfaqësuesit të tij. Shteteve kontraktuese u kërkohet të ndërhyjnë vetëm nëse një dështim nga avokati për të ofruar përfaqësim efektiv është i dukshëm ose u vihet mjaftueshëm në vëmendje në ndonjë mënyrë tjetër (*shih Daud kundër Portugalisë, viti 1998, § 38*). Përgjegjësia e shtetit mund të lindë kur një avokat thjesht nuk vepron në favor të të akuzuarit (*shih Artico kundër Italisë, viti 1980, §§ 33 dhe 36*) ose kur ai nuk përmbush një kërkesë thelbësore procedurale që nuk mund të barazohet thjesht me një linjë të padrejtë mbrojtjeje ose një defekt të thjeshtë argumentimi (*shih Ççekalla kundër Portugalisë, viti 2002, §§ 65 dhe 71*).

24. Gjykata evidenton se neni 141 i Kushtetutës i ka dhënë Gjykatës së Lartë kompetencën e shqyrtimit të çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit. Roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për shkak të këtij roli kushtetues të Gjykatës së Lartë, KPP-ja përmban rregulla të posaçme që garantojnë gjykimin e drejtë për t'iu përgjigjur nevojës së mbrojtjes profesionale efektive të individit, në kuptim të aftësive të përshtatshme për të debatuar realisht mbi kuptimin dhe zbatimin e ligjit sipas rrethanave të veçanta të rekursit. Kështu, neni 435, pika 2, i KPP-së parashikon se akti i rekursit të individit duhet të nënshkruhet, me pasojë mospranimi, nga mbrojtësi, ndërsa sipas nenit 437, pika 3, në shqyrtimin e çështjes në seancë me praninë e palëve, i pandehuri përfaqësohet nga mbrojtësi. Kur i pandehuri nuk ka mbrojtës të zgjedhur, kryetari i kolegjit cakton një mbrojtës kryesisht dhe në këtë rast lajmërimet i bëhen edhe të pandehurit (neni 435, pika 2, fjalë e dytë, i KPP-së). Kjo do të thotë që në ndryshim nga dy shkallët e tjera të gjykimit, gjykimi në Gjykatën e Lartë, sidomos kur çështja shqyrtohet mbi bazën e rekursit që përmban shkaqe ligjore, është i orientuar në debat profesional mbi kuptimin dhe zbatimin e drejtë të ligjit, prandaj e drejta e mbrojtjes nevojitet të jetë substanciale, në kuptimin që gjykata dhe avokati duhet të ushtrojnë në mënyrë reale dhe efektive rolin dhe përgjegjësitë, që u ngarkon ligji.

26. Gjykata thekson se situata juridike, kur rekursi paraqitet nga individ, nuk është e njëjtë me rastin kur rekursi paraqitet nga prokurori. Rekursi i paraqitur nga prokurori mbart në vetvete

mundësinë e përkeqësimit të pozitës së individit, ndaj gjykatat duhet të tregojnë kujdes të shtuar për t'i siguruar individit mbrojtje efektive në funksion të gjyqimit të drejtë. Kur ekziston mundësia e rëndimit të pozitës së individit, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të mbajnë në konsideratë disa standarde minimale, të cilat përfshijnë, por pa u kufizuar në to: veprimet verifikuese nëse ankimi/rekursi i është komunikuar rregullisht individit dhe mbrojtësit të tij për t'u siguruar që ai ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim dhe zgjedhja e një mbrojtësi; zhvillimin e një debati të vërtetë ndërmjet palëve ndërgjyqëse; sigurimin që mbrojtësi i caktuar është njohës i çështjes dhe ka shprehur interes për gjendjen dhe situatën e individit nëpërmjet aksesit në dosjen gjyqësore dhe marrjes së informacionit të plotë dhe të saktë për çështjen e tij; rolin aktiv të mbrojtësit në kryerjen e veprimeve procedurale të parashikuara nga ligji që dëshmojnë realisht mbrojtjen e interesit të të gjykuarit; kohën e caktimit të mbrojtësit për t'i mundësuar atij kushtet e duhura, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të studiuar dosjen dhe për të përgatitur mbrojtjen; mënyrën e paraqitjes dhe artikulimin e argumenteve të përdorura nga mbrojtësi gjatë procesit, për të treguar se ai nuk është në situatën e “dështimit të dukshëm” në përmbushjen e detyrave të tij; realizimin e kontakteve të mbrojtësit me individin për t'i siguruar atij ndihmë juridike efektive; ndërhyrjen e gjykatës kur ajo vlerëson se përfaqësimi nga ana e avokatit mbrojtës është dukshëm joefektiv ose tepër i dobët.

27. Gjykata vëren se mbrojtja nga një avokat i caktuar kryesisht, që i ofrohet individit në procesin penal, është pjesë e skemës së mbrojtjes së detyrueshme që ofrohet nga shteti konform nenit 49 të KPP-së. Kjo skemë mbrojtjeje ndjek qëllim të ngjashëm me atë të ndihmës juridike të ofruar nga shteti bazuar në ligjin nr. 111/2017, datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Në thelbin e tyre, skemat e ndihmës juridike që ofrohen nga shteti synojnë të sigurojnë aksesin në drejtësi, mosdiskriminimin dhe cilësinë e shërbimit të mbrojtjes në funksion të procesit të rregullt, që në rastin e procesit penal materializohet në gjykimin e drejtë. Veprimtaria e mbrojtësit në kuadër të skemave të ofruara nga shteti ushtrohet duke përmbushur njëkohësisht edhe detyrimet që ai ka në bazë të ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”. Sipas këtij të fundit, avokati ka detyrimin t'i sigurojë çdo klienti që përfaqëson mbrojtje profesionale, të drejtë dhe efektive në funksion të realizimit me besnikëri të interesave të tij, të veprojë me profesionalizëm, besnikëri, ndershmëri dhe dinjitet, të udhëhiqet nga interesat e klientit, si dhe të garantojë mbrojtje ose përfaqësim transparent në interesin më të mirë të klientit që përfaqëson. Veprimtaria e avokatit mbikëqyret nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë, e cila përgjigjet për kontrollin e ushtrimit të profesionit të avokatit. Në këtë pikëpamje është përgjegjësi e të gjithë aktorëve të përfshirë në skemat e ndihmës juridike të garantojnë zbatimin efektiv të legjislacionit në fuqi, me të cilin synohet që edhe individit, në situata pamundësie për të zgjedhur mbrojtës ose kur mbrojtja është e detyrueshme, t'i respektohen të drejtat kushtetuese dhe dinjiteti njerëzor.

28. Në këtë pikëpamje, realizimi substancial i mbrojtjes së individit është në radhë të parë përgjegjësi e mbrojtësit, që pranon detyrën e caktuar, duke vijuar më tej me përgjegjësinë që ka Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë, e cila, në kuadër të vetërregullimit, ka për detyrë të mbikëqyrë dhe të kujdeset për veprimtarinë profesionale që ushtron mbrojtësi, duke e përmbyllur me rolin që duhet të luajnë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përfshirë Gjykatën e Lartë, të cilat duhet të sigurojnë realisht të drejtën kushtetuese të mbrojtjes së individit. Për më tepër, kur gjykata e juridiksionit të zakonshëm, përfshirë Gjykatën e Lartë, konstaton se përgjegjësitë qartazi nuk përmbushen, ato ka përgjegjësinë që ta raportojnë rastin për verifikim dhe kontroll pranë organit kompetent.

29. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuesi ka marrë njoftim rregullisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier për rekursin e ushtruar nga prokurori (*shih paragrafët 5, 7 dhe 8 të këtij vendimi*). Pas regjistrimit të rekursit në datën 7.7.2017, Gjykata e Lartë me aktin pa datë “*për kalimin e çështjes gjyqësore gjyqtarit të caktuar*” ka caktuar trupin gjykues dhe relatorin e çështjes, duke e

kategorizuar në çështje penale – seancë gjyqësore. Me vendimin e datës 22.1.2021 Kolegji Penal, pasi ka shqyrtuar në dhomë këshillimi rekursin e prokurorit, ka vendosur kalimin për gjykim të çështjes penale, duke vlerësuar se ai ishte paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 435 i KPP-së, se kërkuesi Roland Karaxha ishte njoftuar dhe se përmbante shkaqet e parashikuara nga neni 432 të po këtij Kodi.

30. Gjykata vëren se pas më shumë se 10 muajve nga dhënia e vendimit për kalimin për gjykim të çështjes (22.1.2021) dhe pas më shumë se 4 vjetëve nga regjistrimi i çështjes (7.7.2017), Gjykata e Lartë, me shkresën nr. 1070/17 prot., datë 13.12.2021, i është drejtuar avokatit të zgjedhur nga kërkuesi, që e kishte përfaqësuar atë në gjykim në shkallë të dytë, me njoftimin se ka caktuar seancë gjyqësore në datën 14.1.2022, duke i bërë me dije edhe përbërjen e Kolegjit Penal. Akti i njoftimit drejtuar avokatit është kthyer nga shërbimi postar me shënimin “larguar – ndodhet jashtë shtetit”, pra njoftimi nuk rezulton t’i jetë dorëzuar mbrojtësit. Nga aktet në dosje rezulton se për kërkuenin sekretaria e Gjykatës së Lartë është mjaftuar me afishimin në faqen zyrtare të datës së zhvillimit të seancës gjyqësore, më 14.1.2022, duke mos kryer njoftim në vendbanimin e tij. Njoftimi me afishim është realizuar në datën 13.12.2021.

31. Në datën 14.1.2022 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar seancën e parë gjyqësore, në të cilën as kërkuesi, as avokati i zgjedhur nuk janë paraqitur. Në procesverbal është evidentuar fakti se i gjykuari “*u thirr dhe nuk është paraqitur*”. Prokurori ka kërkuar caktimin e një mbrojtësi kryesisht për kërkuenin, duke vënë në dukje se prania e tij ishte e domosdoshme sipas ligjit. Kolegji Penal ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore, pas një jave, në datën 21.1.2022 dhe caktimin e një avokati kryesisht për kërkuenin, por pa shënuar në procesverbal emrin konkret të avokatit. Gjykata e Lartë, brenda ditës, ka afishuar në faqen zyrtare elektronike listën e çështjeve penale për shqyrtim në datën 21.1.2022, ku përfshihej edhe çështja e kërkuenis.

32. Kolegji Penal ka njoftuar me shkrim për seancën gjyqësore avokatin J.K., në cilësinë e mbrojtësit të caktuar kryesisht. Akti i njoftimit, jo vetëm që nuk përmban numër dhe datë, por në përmbajtje ka edhe pasaktësi të dukshme. Aty pasqyrohet se Gjykata e Lartë ka zhvilluar seancë gjyqësore në datën 7.1.2022, në të cilën është caktuar të marrë pjesë avokati i caktuar kryesisht si përfaqësues i shoqërisë “P.” sh.p.k. Kjo e fundit nuk rezulton të ketë ndonjë lidhje me kërkuenin ose çështjen e tij. Ndërkohë që seanca e parë që i përket çështjes së kërkuenis nuk është zhvilluar në datën 7.1.2022, por në datën 14.1.2022, gjatë së cilës Kolegji Penal ka marrë vendim të ndërmjetëm për shtyrjen e seancës për të siguruar pjesëmarrjen e mbrojtësit, por pa caktuar konkretisht një të tillë. Në këtë mënyrë, caktimi kryesisht i mbrojtësit nga Gjykata e Lartë është karakterizuar nga formalizmi, duke mos iu përgjigjur efektivitetit dhe profesionalizmit të mbrojtjes që kërkon gjykimi në seancë në Gjykatën e Lartë. Në këtë pikë, gjithashtu, duhet evidentuar se në çështjen konkrete dy gjykatat më të ulëta kishin dhënë vendime të ndryshme, duke interpretuar ligjin në mënyra diametralisht të kundërta, fakt i cili kërkonte vëmendje të shtuar profesionale nga ana e mbrojtësit.

33. Në seancën gjyqësore të datës 21.1.2022, avokati i caktuar kryesisht ka paraqitur dhe lexuar mendimin me shkrim, dhe në përfundim ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë. Kolegji Penal nuk rezulton t’i ketë bërë ndonjë pyetje ose vërejtje mbrojtësit, por e ka konsideruar të realizuar mbrojtjen e individit dhe ka dhënë vendimin përfundimtar, duke pranuar rekursin e prokurorit dhe duke përmbysur në disfavor të kërkuenis rezultatin që ishte vendosur nga gjykata e apelit (*shih procesverbalin gjyqësor të datës 21.1.2022*). Nga shqyrtimi i mendimit me shkrim, pa datë dhe gjithsej 2 fletë, të nënshkruar nga mbrojtësi dhe të administruar në dosjen gjyqësore, konstatohet mungesa e qartë jo vetëm e argumentimit ligjor për çështjen, në kuptim të interpretimit të ligjit sipas rrethanave të çështjes, por edhe e kërimit/qëndrimit përfundimtar mbi objektin e rekursit të prokurorit. Po kështu, në mendimin me shkrim, ndonëse tepër i shkurtër, vihen re mospërputhje të konsiderueshme të të dhënave dhe paqartësi në paraqitjen e rastit. Kështu, në

paragrafët e tretë, të katërt dhe të pestë të faqes 2 të këtij materiali të dhënat e referuara nuk përkojnë me rrethanat e rastit të kërkuarit, për më tepër në përmbajtje (paragrafi i katërt) janë vendosur të dhënat e plota të një të dënuari tjetër (emër, mbiemër, atësi, amësi, datëlindje dhe vendlindje).

34. Gjykata vëren se gjykimi i çështjes së kërkuarit në Gjykatën e Lartë është vënë në lëvizje nga rekursi i prokurorit dhe, në përfundim, pozita e tij është rënduar. Në kushtet kur shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore në Gjykatën e Lartë karakterizohet nga debati profesional mbi kuptimin e ligjit, thjesht dhe vetëm “caktimi” i një mbrojtësi nuk mjaftonte për të siguruar ndihmë juridike efektive për kërkuarin. Mbrojtësi i caktuar nuk rezultoi të ketë përmbyllur përgjegjësinë e tij realisht dhe në interes të kërkuarit, në kuptimin e studimit dhe përgatitjes së mbrojtjes në nivel të përshtatshëm profesional dhe të formulimit të argumenteve ligjore sipas shkaqeve të ngritura në rekurs dhe rrethanave të çështjes konkrete. Ndërsa Gjykata e Lartë nuk rezultoi të ketë marrë masat e duhura për të riparuar këtë situatë, si për shembull ta kishte ftuar avokatin e caktuar kryesisht që të shtonte ose korrigjonte materialin mbrojtës në vend që të zgjidhte çështjen dhe të arsyetonte vendimin e saj bazuar vetëm në argumentet ligjore të prokurorisë.

35. Në këtë kontekst, Gjykata rithekson se në vështirësi të standardeve kushtetuese, jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017; nr. 30, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Garantimi i së drejtës kushtetuese për t’u mbrojtur në procesi penal sipas neneve 31 dhe 42 të Kushtetutës, që bazohet në rëndësinë e kësaj të drejte në kuptim të gjyqimit të drejtë, vendos detyrimin jo vetëm për caktimin formalisht të një mbrojtësi, por edhe sigurimin e mbrojtjes reale. Në këtë drejtim, Gjykata çmon se caktimi i një mbrojtësi kryesisht për kërkuarin ka dështuar për shkak të cilësisë së mbrojtjes që është ofruar në nivel të tillë sa mund të konsiderohet se kërkuari nuk ka pasur mbrojtës, për rrjedhojë, pavarësisht kompetencës ekskluzive të Gjykatës së Lartë për interpretimin e ligjit dhe mënyrës së zgjidhjes së çështjes, bëhet fjalë për shkelje thelbësore të procesit, që e bën atë të parregullt.

36. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se avokati i caktuar kryesisht për kërkuarin ka dështuar në mënyrë të dukshme për t’i ofruar atij mbrojtje efektive dhe se Gjykata e Lartë nuk ka ndërhyrë për marrjen e masave të duhura. Në këtë mënyrë, e drejta e mbrojtjes e kërkuarit është realizuar vetëm formalisht, pa plotësuar standardin substancial të saj, për rrjedhojë ka mbetur një e drejtë iluzive dhe teorike.

37. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e procesit të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës së mbrojtjes është i bazuar dhe kërkesa duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-129 (16), datë 21.1.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe ridërgimin e çështjes për rishqyrtim pranë saj.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 17.11.2022.
Shpallur, më 19.12.2022.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Elsa Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari

Anëtarë kundër: Fiona Papajorgji, Altin Binaj, Ilir Toska

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual të paraqitur nga kërkuesi Roland Karaxha, me objekt shfuqizimin e vendimit gjyqësor të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, ne, gjyqtarët në pakicë, jemi kundër qëndrimit të shumicës që ka vlerësuar se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes është i bazuar dhe, si i tillë, duhet të pranohet. Prandaj, në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, parashitrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për të zgjedhur një avokat për ta përfaqësuar në gjykim dhe se ai ka marrë dijeni pas dhënies së vendimit, në momentin e arrestimit në datën 12.4.2022. Sipas tij, prokuroria ka ushtruar rekurs vetëm kundër vendimit në rastin e tij, ndërsa nuk ka bërë të njëjtën gjë ndaj vendimit gjyqësor për babain e tij, i cili kishte përfituar në të njëjtën mënyrë nga amnistia (*shih paragrafin 19 të vendimit*).

3. Shumica, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimin e kërkuesit dhe prapësimet e subjektit të interesuar, ka arritur në përfundimin se është cenuar e drejta e mbrojtjes me arsyetimin se “... *avokati i caktuar kryesisht për kërkuesin ka dështuar në mënyrë të dukshme për t’i ofruar atij mbrojtje efektive dhe se Gjykata e Lartë nuk ka ndërhyrë për marrjen e masave të duhura. Në këtë mënyrë, e drejta e mbrojtjes e kërkuesit është realizuar vetëm formalisht, pa plotësuar standardin substancial të saj, për rrjedhojë ka mbetur një e drejtë iluzive dhe teorike.*” (*shih paragrafin 36 të vendimit*).

4. Ne biem dakord me shumicën në nivel parimor, teksa shprehet për përmbajtjen e së drejtës së mbrojtjes, veçanërisht në procesin penal, e cila duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike, dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t’i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, të cilat së bashku, në vetvete, përbëjnë elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij (*shih paragrafin 22 të vendimit*).

5. Gjithsesi, ne, gjyqtarët në pakicë, duam të theksojmë se në rastin në shqyrtim kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së mbrojtjes për shkak se Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për të zgjedhur një avokat për ta përfaqësuar në gjykim. Në këtë drejtim sjellim në vëmendje rregullat e njoftimit për gjykimin në Gjykatën e Lartë, të parashikuara nga neni 436, paragrafi 3, i KPP-së, të cilat përcaktojnë se: “*Sekretaria e gjykatës njofton palët nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare për datën dhe orën e gjyimit të paktën 30 ditë përpara. Kur palët kanë adresa elektronike të deklaruar apo të njohura, sekretaria kryen njoftimin edhe në këto adresa.*”.

6. Sikurse edhe shumica pranon, për seancën e parë gjyqësore sekretaria e Gjykatës së Lartë ka njoftuar palët nëpërmjet afishimit në faqen elektronike zyrtare për datën dhe orën e gjykimit të paktën 30 ditë përpara. Po kështu, i është dërguar njoftim shkresor avokatit që kërkuesi kishte zgjedhur me deklaram në gjykatën e apelit, pavarësisht faktit se ai nuk ishte i pajisur me akt përfaqësimi për të mbrojtur kërkuenin në Gjykatën e Lartë. Njoftimi për këtë të fundit nuk është arritur, ndërsa shërbimi postar ka konfirmuar se ai ndodhej jashtë shtetit. Edhe për seancën e radhës është bërë njoftim nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, vlerësojmë se njoftimet e Gjykatës së Lartë janë bërë në përputhje me kërkesat e ligjit procedural penal, prandaj pretendimi i kërkuetit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes për shkak të mosnjoftimit të tij nga Gjykata e Lartë është i pabazuar.

7. Në vlerësimin tonë shumica ka dalë përtej fakteve dhe argumenteve të parashtruara nga kërkuesi në funksion të pretendimit të ngritur prej tij, pasi cenimin e së drejtës së mbrojtjes e ka trajtuar në aspektin e cilësisë së mbrojtjes së ofruar në rastin konkret nga ana e mbrojtësit të caktuar kryesisht për kërkuenin. Lidhur me këtë mënyrë trajtimi nga shumica të pretendimit të kërkuetit, vlerësojmë se ajo ka dalë përtej natyrës së procesit të gjykimit kushtetues. Ky proces ka natyrë argumentuese, çka nënkupton se janë palët ato që parashtrojnë argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështetin pretendimet e tyre, pra është detyrë e tyre të shpjegojnë arsyet të cilat kanë çuar, sipas këndvështrimit të tyre, në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë.

8. Konkretisht, neni 27 i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se kërkesa në Gjykatën Kushtetuese duhet të përmbajë, ndër të tjera, parashtrimin e shkaqeve (*shkronja "d"*), si dhe treguesin e dokumenteve dhe mjeteve të tjera provuese që shoqërojnë kërkesën (*shkronja "dh"*). Bazuar në parimin *iura novit curia*, Gjykata mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimt të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj, por kurrësi ajo nuk mund të marrë në vlerësim dhe as të cilësojë fakte ose argumente që nuk janë paraqitur nga kërkuesi.

9. Përtej kësaj, lidhur me substancën e pranuar nga shumica, ndërsa vlerësojmë se cilësia e mbrojtjes së ofruar nga mbrojtësi i caktuar kryesisht nuk është ajo e duhura/e arrirë, çmojmë se ajo nuk ka ndikuar në zgjidhjen e çështjes në rastin konkret nga Gjykata e Lartë. Për këtë kemi në vëmendje se objekt shqyrtimi gjyqësor nga Gjykata e Lartë ka qenë vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, me të cilin është ndryshuar vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke u pranuar kërkesa e kërkuetit për përfitimin nga amnistia. Në këtë rast, Gjykata e Apelit Vlorë ka pranuar qëndrimin e kërkuetit dhe mbrojtësit të zgjedhur prej tij lidhur me interpretimin dhe zbatimin e ligjit të amnistisë. Në këtë pikëpamje mbetet të pranohet se në rrjedhën e këtij procesi kërkuesi ka pasur mundësinë dhe ka arritur të prezantojë një mbrojtje cilësore, për sa kohë pretendimet e tij mbi interpretimin dhe zbatimin e ligjit të amnistisë janë gjetur të drejta dhe janë pranuar nga gjykata e apelit. Ndërkohë, siç u përmend, duke qenë se objekt shqyrtimi gjyqësor nga Gjykata e Lartë ka qenë vendimi i gjykatës së apelit, që në thelb përmban qëndrimin e vetë kërkuetit, Gjykata e Lartë, në funksion të shqyrtimit të saj, ka pasur parasysh dhe praktikisht ka shqyrtuar qëndrimin e vetë kërkuetit të parashtruar përmes një mbrojtjeje të pranuar si cilësore. Në këtë kuptim, duke pasur parasysh se çështja nuk paraqitet komplekse, për sa kohë bëhet fjalë për dy mënyra të ndryshme të interpretimit të ligjit penal, interpretime këto që janë shfaqur gjatë rrjedhës së procesit (njëri nga gjykata e shkallës së parë dhe tjetri nga gjykata e apelit), nuk duket që mbrojtja e kërkuetit në Gjykatën e Lartë ka mundësi për risi, pra për të sjellë ndonjë argument tjetër të ri në favor të tij të parashtruar më parë. Në këtë pikëpamje vlerësojmë se cilësia e mbrojtjes së ofruar për kërkuenin nga mbrojtësi i caktuar kryesisht nuk ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë nga Gjykata e Lartë.

10. Edhe vetë kërkuesi nuk ka parashtruar asnjë argument se çfarë shkaqesh të reja do të mund të ngrinte në Gjykatën e Lartë nëse do të kishte pasur mundësinë e zgjedhjes së mbrojtësit nga ana e tij gjatë atij gjykimi. Për më tepër, Kolegji Penal i kësaj gjykate ka theksuar se: “*Vendimi i ankimuar ijen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.*”. Nisur nga kjo, edhe duke pranuar se mbrojtja e kërkuesit në Gjykatën e Lartë nga mbrojtësi i caktuar kryesisht nuk përmbush mjaftueshëm standardet e një mbrojtjeje cilësore/efektive, kjo anomali, në kontekstin e rastit konkret, nuk mund të konsiderohet si shkelje thelbësore që bën të parregullt, në kuptimin kushtetues, procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë.

11. Në përfundim, vlerësojmë se Gjykata duhet të kishte vendosur rrëzimin e kërkesës të paraqitur nga kërkuesi Roland Karaxha.

Anëtarë: Ilir Toska, Fiona Papajorgji, Altin Binaj